



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.838/18 prot.

Tiranë më 6.12.2022

VENDIM

Nr. 58, datë 6.12.2022

PËR REFUZIM RISHIKIMI TË AKTIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje të Kreut IV, neneve 144-146 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), neneve 30 dhe 31, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, (në vijim Ligji), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

VËREN:

Në zbatim të neneve 16 dhe 30 të Ligjit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka ushtruar hetim administrativ pranë kontrolluesit “Noter Albana Spahiu” (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasit I. D., dhe I. SH., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Komisioneri pasi ka shqyrtuar ankesat e subjekteve të të dhënave procesin hetimor relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, ka vendosur:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;

4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.3, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për sa i përket tabelave informuese;
5. Kontrolluesi në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit", në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 4 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.

Kundër Vendimit nr. 41, datë 31.10.2022, Kontrolluesi me shkresën nr. 838/14. prot., datë 09.11.2022, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit kërkesën për rishikim të vendimit sipas Nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në lidhje me kërkesën për rishikim nga Kontrolluesi dhe pretendimeve të paraqitura në të, Zyra e Komisionerit vlerëson, si në vijim.

Përsa i përket pretendimit se, Kontrolluesi ka qenë në të njëjtat kushte me kontrolluesit e tjerë për të cilët është vendosur me akt rekomandues, ky pretendim nuk qëndron sepse, rasti në fjalë, përbën një situatë apo rrethanë serioze që ka të bëjë me hyrjen/daljen e një të miture nga territori i Republikës së Shqipërisë. Në referencë të dispozitave të ligjit dhe me argumentimin përkatës të reflektuar në Vendimin objekt rishikimi, situata është vlerësuar nga Komisioneri si rast i shkeljes serioze dhe që vjen në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale. Në përfundim, Zyra e Komisionerit ka dalë me vendimarrjen përkatëse, me të cilën Kontrolluesi është njoftuar rregullisht.

Në këto kushte, Komisioneri ka vlerësuar serioze situatën në fjalë, pavarësisht faktit se Kontrolluesi nuk ishte në rrethanat e përsëritësit por, gjendej në kushtin e parë të nenit 30 të Ligjit, pika 2 i tij, ku saktësohet se, "*Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".

Masa e sanksionit, materializuar nëpërmjet aktit të Komisionerit, është minimizuar, duke pasur parasysh limitet e lejuara e të ligjshme, të sanksionuara në nenin 39 të Ligjit, pikërisht, se Kontrolluesi nuk ka qenë përsëritës.

Gjithashtu, ky pretendim, nuk plotëson kushtet për tu konsideruar si një provë, për rishikim të Vendimit, në referencë të Nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në kërkesën për rishikim, Kontrolluesi ndër të tjera pretendon se (citojmë): “pasi kam vizituar faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit, u njoha me 3 Rekomandime, ku një prej tyre është Rekomandimi nr. 33 datë 21.10.2022 për Dhomën Kombëtare të Noterisë, sipas të cilit sanksionet administrative për kundërvajtjet administrative vendosen në rastin e shkeljeve serioze, të përsëritshme ose të qëllimshme.

Dy rekomandimet, përkatësisht Rekomandimi nr. 1 datë 14.07.2022 dhe Rekomandimi nr.2 datë 14.07.2022, të Zyrës së Komisionerit, janë dhënë për dy subjekte që ushtrojnë profesionin e noterit dhe kanë situata shumë të ngjashme me situatën e konstatuar gjatë hetimit administrativ të ushtruar pranë zyrës sime”.

Në zbatim të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, bazë ligjore e pretenduar nga Kontrolluesi dhe provat që kanë lidhje me Rekomandimet e sipërcituara, nuk janë të tilla, që do të kishin çuar në një akt administrativ të ndryshëm nga ai i nxjerrë.

Në lidhje me rekomandimet në fjalë, Kontrolluesi ka pasur mundësinë të marrë dijeni dhe të paraqesë dokumentet gjatë procedurës administrative, të njihet me faktet dhe nuk e ka bërë këtë. Sjellim në vëmendje, që aktet në fjalë datojnë afërsisht 3(tre) muaj përpara daljes së Vendimit për Kontrolluesin. Përveç kësaj, këto vendimmarrje kanë qenë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit dhe mund të konsultoheshin lehtësisht.

Përsa i përket pretendimit të Kontrolluesit për sanksionim para daljes së Rekomandimit Unifikues Nr.33, datë 21.10.2022 të Komisionerit, “Për Dhomën Kombëtare të Noterisë”, si akt detyrues, Zyra e Komisionerit vlerëson që ky pretendim gjithashtu nuk qëndron, sepse, nuk ndryshon apo lehtëson rrethanat e shprehura nëpërmjet Vendimit Nr.41, datë 31.10.2022 të Komisionerit. Në të njëjtën logjikë edhe për dy rekomandimet e mëparshme, këto prova nuk kanë qenë të paditura nga Zyra e Komisionerit, në vendimmarrjen e tij dhe nuk hyjnë në kategorinë e atyre provave, që në referencë të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, do të anulonte apo ndryshonte vendimmarrjen për Kontrolluesin.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 146, të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

V E N D O S A:

1. Refuzimin e kërkesës nr. 838/14 prot., datë 09.11.2022 të Kontrolluesit “Notere Albana Spahiu” për rishikimin e aktit administrativ, Vendimi nr. 41, datë 31.10.2022

të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe lënien në fuqi të tij.

2. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u dha sot në datë 6.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi